



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:067591

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05636111

KE.nr.1917/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike të paditësit S.B., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, me seli Rr.“Holger Petersen”, Objekti Park Residence, Hy.4, Nr.2, në Prishtinë, kundër të paditurit Shtëpia Botuese “Dukagjini”, Rr.“Xhevdet Doda”, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Vjosa Shkodra me seli të zyrës në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit jomaterial për shkelje të drejtës së autorit, vlera e kontestit 5,000.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 02.04.2023, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të të paditurit, me datën 15.04.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.B., ashtu që DETYROHET e paditura Shtëpia Botuese “Dukagjini”, që në emër të dëmit jomaterial të shkaktuar për shkeljen e të drejtës autoriale, t’ia kompensoj paditësit shumën prej 5,000.00 Euro (pesëmijë euro), me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në përmbushjen definitive, në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II.OBLIGOHET e paditura që në kopertinën e librit Matematika 2b me fletore pune për klasën e dytë, ta shkruajë emrin e paditësit si bashkë autor, në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III.DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 959.60 € (nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë cent), në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

### A r s y e t i m

Paditësi S.B., i përfaqësuar sipas autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata” me seli në Prishtinë, me datën 05.04.2022, pranë gjykatës, ka paraqitur padi për kompensim të dëmit, kundër të paditurit Shtëpia Botuese “Dukagjini”, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që në emër të dëmit të shkaktuar për shkak të mos shënimit të emrit të paditësit si bashkëautor në kopertinën e tekstit shkollor Matematika 2b me fletore pune, paditësit t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 5,000.00 €, dhe kamatën ligjore në lartësi prej 8 % prej datës së paraqitjes së padisë e deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Po ashtu me padi ka kërkuar kompensimin për detyrimin e papërmbushur në emër të pagesës për të drejtat e autorit për tekstet shkollore: Matematika 4 fletore pune, Matematika 4 për vlerësimin e njohurive, Matematika 5, Matematika 5 fletore pune, dhe Matematika 5 fletore pune për vlerësimin e njohurive për botimin e vitit shkollor 2021/2022, dhe atë dyfishin kontraktual me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % duke filluar nga data e parashtrimit të padisë.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se pasi paditësi ka kuptuar se në kopertinën e tekstit shkollor të sipërcekur nuk është shënuar emri i tij si bashkëautor i tekstit shkollor Matematika 2b me fletore pune për klasën e dytë, i njëjti përmes të autorizuarës së tij i është drejtuar të paditurës me kërkesë për përmbushje të obligimeve ligjore dhe kontraktuale, dhe atë dy herë rradhazi, mirëpo e paditura deri më tani nuk i është përgjigjur kërkesës së paditësit. Më tej ka theksuar se me veprimet/mosveprimet e të paditurës, paditësit i janë shkelur të drejtat morale të tij të garantuara me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Tutje ka shtuar se e paditura ka dështuar që të përmbush detyrimet e veta ligjore, duke shkelur kështu të drejtën e autorit këtu paditësit që emri i tij të përfshihet në librin e botuar. Paditësi gjatë seancave gjyqësore ka precizuar kërkesëpadinë sa i përket lartësisë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit jomaterial në shumën prej 5,000.00 Euro, si dhe është tërhequr nga pika 4 e petitumit

të kërkesëpadisë sa i përket kompensimit për detyrimin e papërbushur në emër të pagesës për të drejtat e autorit për tekstet shkollore Matematika 4 dhe 5. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I padituri gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se paditësi dhe i padituri nuk kanë pasur marrëveshje për hartimin e librit Matematika 2b. Lidhur me këtë libër që është objekt kontesti, prof.R.Z. dhe z.B., janë dakorduar që për t'u njohur kontributi i të dy autorëve Matematika 2b të jetë emri i prof.R.Z., kurse në teste të matematikës së II-të të mbetet emri i paditësit, dhe ky bashkëpunim ka rrjedhur mirë qysh në hartimin e librit të matematikës së parë e tutje, dhe kjo ka qenë marrëveshje në mes të dy autorëve për të cilën e paditura nuk e ka obligim e nuk duhet të ndërhyjë në punën e autorëve. Tutje ka theksuar se Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta e përcakton punën në mes të bashkëautorëve, me ç'rast nëse bashkëautorët kanë rënë dakord për kontributin e secilit, prezantohet tek shtëpia botuese, ndërsa shtëpia botuese nuk ka detyrim ligjor të ndërhyjë në marrëdhëniet e autorëve por i boton librat ashtu si i prezantohet nga puna të cilën e ndajnë bashkëautorët. Ka shtuar se paditësit i është njohur e drejta autoriale, madje në librin Matematika 2b ani pse e hartuar nga prof.R.Z., i është vënë emri në faqen e parë, menjëherë pas kopertinës, ashtu siç edhe është dakorduar, dhe i njëjti është kompensuar për punën e tij. Ka kërkuar nga gjykata që të mos ia fal besimin paditësit, për faktin se kërkesëpadia nuk gëzon mbrojtje ligjore e as faktike, e cila është paraqitur me të vetmin qëllim, përfitimin material pa asnjë bazë ligjore.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Matematika 2b, për klasën e dytë të arsimit fillor, e autorit R.Z., Kërkesa drejtuar të paditurës, Shtëpisë Botuese "Dukagjini" e datës 09.03.2022, Kërkesa drejtuar të paditurës, Shtëpisë Botuese "Dukagjini" e datës 24.03.2022, si dhe Ekspertiza financiare e ekspertit A.B..

Gjykata pasi ka bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Libri Matematika 2b për klasën e dytë të arsimit fillor, është vërtetuar fakti se në kopertinën e këtij libri, figuron si autor i vetëm R.Z., ndërsa në faqen e parë të këtij libri figuron emri i bashkëautorëve R.Z. dhe paditësit S.B..

Nga Kërkesa drejtuar të paditurit, Shtëpisë Botuese “Dukagjini” e datës 09.03.2022, dhe ajo e datës 24.03.2022, është vërtetuar fakti se paditësi ka kërkuar nga i padituri që edhe emri i bashkëautorit S.B. të shkruhet në kopertinën e librit Matematika 2b me fletore pune për klasën e dytë, si dhe Shtëpia Botuese të del me një komunikatë ku ia njuh të drejtën e autorësisë si bashkëautor i kësaj vepre.

Nga ekspertiza financiare e ekspertit gjyqësor për sigurime, aktuaristikë dhe çështje ekonomike-financiare, A.B., është konstatuar se dëmi jomaterial-moral që i është shkaktuar bashkëautorit të librit Matematika 2b me fletore pune për klasën e dytë, tani paditësit S.B., për shkak të mos paraqitjes së emrit të tij në kopertinë si bashkëautor me rastin e përgatitjes për opinion dhe shpërndarjes së librit lexuesve, mund të vlerësohet në formë të një satisfaksioni moral në lartësi prej 5,000.00 Euro.

Nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse dhe provat e administruara, rezulton se në rastin konkret kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte nëse i padituri me mosvendosjen e emrit të të paditurës si bashkëautor në kopertinën e librit Matematika 2b, ka bërë shkelje të së drejtës autoriale dhe nëse të paditurit i bie barra për kompensimin e dëmit, në emër të dëmit jomaterial të shkaktuar për shkak të mos vendosjes së emrit të paditësit në kopertinën e librit.

Me nenin 6 par.2 nën par.2.1 të Ligjit Nr. 2004/45 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta është përcaktuar që e drejta e autorit përmban: *“autorizimet ekskluzive personale për të mbrojtur pacenueshmërinë e veprës së autorit dhe personalitetin e autorit, në vijim: të drejtat morale të autorit”*. Ndërsa, me nenin 18 par.1 të Ligjit është përcaktuar se *“Autori ka të drejtën ekskluzive të njihet dhe të shënohet si autor i veprës”*.

Më tutje, me nenin 8 par.1 të Ligjit është përcaktuar që *“Vepra të autorit janë krijimet intelektuale origjinale në lëmin e letërsisë, të shkencës dhe artit, që janë të shprehura në çfarëdo mënyre, nëse me këtë ligj nuk parashikohet ndryshe.”*, ndërsa në par.2 nën par.2.2 të

po këtij neni është përcaktuar se vepra të autorit konsiderohen në veçanti “*veprat e shkruara, siç janë tekstet në libra, broshurat, gazetat ditore dhe tekste të tjera në lëmin e letërsisë, literaturës shkencore e profesionale, si dhe programe kompjuterike*”.

Duke u bazuar në dispozitat e sipërcituara, gjykata gjeti se teksti i librit Matematika 2b me fletore pune për klasën e dytë të arsimit fillor, hyn në kuadër të veprave të cilat përbëjnë vepër autoriale dhe të cilat gëzojnë mbrojtje ligjore.

Në rastin konkret, në kontekstin e përgjithshëm të procedurës provuese gjykata gjeti se i padituri me mos vendosjen e emrit të paditësit në kopertinën e librit Matematika 2b me fletore pune për klasën e dytë të arsimit fillor, ka cenuar të drejtën ekskluzive-morale të paditësit të njihet dhe të shënohet si autor i veprës.

Vendimin në lidhje me lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e ka bazuar në raportin e ekspertizës financiare, të punuar në këtë çështje juridike nga eksperti A.B., i cili ka konstatuar se dëmi jomaterial-moral që i është shkaktuar paditësit S.B., për shkak të mos paraqitjes së emrit të tij në kopertinë si bashkëautor me rastin e përgatitjes për opinion dhe shpërndarjes së librit lexuesve, mund të vlerësohet në formë të një satisfaksioni moral në lartësi prej 5,000.00 Euro.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në konstatimet e ekspertit, gjykata ka ardhur në përfundim se shuma e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është kompensim real për dëmin moral që i është shkaktuar paditësit si rezultat i mos vendosjes së emrit të paditësit në kopertinën e librit nga ana e të paditurës.

Gjykata duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, me të cilin përcaktohet se: “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*”, e miratoi kamatëvonesën e kërkuar, ashtu që e detyroi të paditurën që përveç shumës në vlerë prej 5,000.00 € në emër të kompensimit, paditësit t’ia paguajë edhe kamatën ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.5 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së

precizuar si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shumën në vlerë prej 959.60 €.

Nga arsyet e cekura më lartë, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1917/22, datë 15.04.2024.

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.